



Disa mendime rreth konceptit të vizionit

“Të gjithë ne jetojmë nën një qiell, por nuk kemi horizont të njëjtë”

Konrad Adenauer

Përcaktimi i qartë i vizionit kërkon qartësim të plotë dhe të pakontestueshëm të konceptit të tij. Duhet pranuar se kjo nuk është e lehtë, sepse ekzistojnë me dhjetëra përkufizime të tij. Megjithatë ne do t'i prezantojmë disa mendime të ekspertëve të kësaj fushe.

Për këtë arsye ka mendime se vizioni, misioni dhe qëllimet janë koncepte që kanë kuptim sinonimik, që do të thotë se nuk dallojnë – janë një (37:22; Mialaret, G. ; Kenny, 1994, Warnet, 1994)

Blum dhe Butler (1985) deklarojnë: “Vizioni është reference për një gjendje të dëshiruar të ardhshme të organizatës. Ka të bëjë me qëllimet e synuara të shprehura në vlera dhe në sqarimin e drejtimeve drejt të cilave shkolla duhet të zhvillohet. Duhet të jetë inspirativ, ashtu që veprimtarët të jenë të motivuar në punën ta zhvillojnë me krenari dhe entuziazëm. Ky është i lidhur ngushtë me përparimin e shkollës”

Vizioni është arti i të parit të paparës, thotë Jonathan Swift. Ai është diçka që ne e paramendojmë e dëshirojmë, është diçka që nuk shihet, andaj dhe përkufizojnë si një imazh mental – mendor të një gjendje të cilën dëshirojmë të jemi, apo kemi organizatën, apo në rastin konkret një imazh i ndërtuar në kokon tonë për profilin e dëshiruar të qytetarit të cilin do ta formojmë nëpërmjet sistemit të edukimit dhe të kurrikulave të cilat i kemi definuar më herët si meny ushqimi me të cilën do zhvillojmë një personalitet dhe individë të fuqishëm do të jetë në gjendje të përballet me sfidat e një kohe dhe një gjendje të cilën ne nuk e njohim, por që e ëndërrojmë ta realizojmë.

Vizioni është një piketë sfiduese – provokuese drejtë të cilës duhet të shkojmë, por që nuk arrihet lehtë

Megjithatë, vizioni nuk guxon të jetë i pa realizueshëm dhe utopik. Ai është në vijë ndërmjet reales dhe të imagjinuarës. Për këtë arsye vizioni është tërheqës, ka një forcë magnetike që të tërheqë dhe nuk të lenë të qetë deri në momentin e realizimit të tij

Thënë ndryshe vizioni është një fanar drite në fund tuneli drejtë të cilës duhet të shkojmë. Është një busull që na tregon drejtimin drejt të cilit duhet të shkojmë

Foreman (1998) vizionin e përshkruan: “Ortodoksia bashkëkohore kërkon që lideri detyrimisht duhet ta ketë vizionin ndriçues të ardhshmes për veten dhe organizatën e cila do të jetë në gjendje të komunikojë dhe të demonstrojë me vendosmëri, me bindje dhe dëshmi... pa vizion, nuk ka drejtim të qartë, shikim ndërveprues përpara dhe përgjegjësi.

Vizion është shenjë dalluese e rolit të liderit. Ky autor vizionin e sheh edhe si një “Fotografi që do të mund të bëhet ideal për personin dhe organizatën dhe rinjeh pakënaqësinë me të tashmen. Ai është katalizator i aksionit dhe reflekton vlerat themelore”.

Për këtë arsye, shoqëria, shkollat, kurrikulat, individët pa vizion nuk janë shoqëri, shkolla, kurrikula, individ produktiv efikas dhe efektiv. Ata ose ato janë bredhacak të “verbër” dhe të dështuar.

E meta kryesore e ndryshimeve të deritashme kurrikulare në Kosovë ka qenë mungesa e vizioneve. Kjo mungesë ka bërë që në ndryshime të mos e kemi dritën në fund të një tuneli të errësuar.

Meqë tani e dimë ç’ është vizioni në vazhdim do të flasim për llojet dhe kriteret që duhet respektuar për formulimin e vizioneve kurrikulare.

Shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Njëra ndër aktivitetet e rëndësishme në kuadër të programit “Grantet për Zhvillimin e Shkollave” është ndërtimi i kapaciteteve të Drejtorive Komunale të Arsimit për të monitoruar implementimin e projekteve shkollore. Për këtë qëllim KEC ka organizuar tri punëtori gjysmë ditore në të cilat kanë marrë pjesë nga 2 përfaqësues të DKA-ve nga mbarë Kosova.

■ Punëtorja e parë është mbajtur më 25 shkurt në Gjakovë dhe në të kanë marrë pjesë përfaqësues të DKA-ve nga rajoni i Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit. Punëtorja e dytë është organizuar në Prishtinë më datën 2 mars dhe në të kanë marrë pjesë përfaqësues të DKA-ve të Prishtinës, Gjilanit, Ferizajt dhe Mitrovicës. Ndërsa punëtorja e tretë për përfaqësuesit e DKA-ve të komunave më shumicë serbe është mbajtur në Prishtinë më 15 mars. Në këto punëtori është prezantuar korniza e monitorimit, e cila do të ju ndihmojë DKA-ve për të realizuar monitorimin e zbatimit të projekteve shkollore.

■ Më 16 mars 2011, në Hotelin Grand në Prishtinë është mbajtur ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjeve të granteve për shkollat përfituese. 110 nga 114 shkollat e aprovuara nga KAGSH në rundin e parë kanë nënshkruar marrëveshje me MASHT për të implementuar projektet, të cilat do t'i kontribuojnë shtimit të cilësisë në shkollat e tyre. 4 shkollat e rundit të parë, projektet e të cilave nuk janë aprovuar nga KAGSH për shkak të mosrespektimit të listës pozitive për financimin e projekteve është dashur të

riformulojnë projektet e tyre. Procesi i ri përgatitjes së projekteve ka përfunduar në këto shkolla dhe pritet që edhe këto shkolla së shpejti të nënshkruajnë marrëveshjet dhe të fillojnë implementimin e projekteve.

KOSOVISION Contest

■ Gjatë këtij muaji të gjithë mësimmshënësit e klasave fituese kanë filluar me realizimin e projekteve shkollore në shkollat e tyre. Nxënësit janë duke punuar me një entuziazëm të madh me shpresën dhe dëshirën që edhe në raundin e dytë të arrijnë qëllimin e planifikuar me mësimmshënësit e tyre. Vizitat nëpër shkolla janë të vazhdueshme nga stafi i projektit.

■ Muaji mars ka qenë edhe muaj fati për disa nga nxënësit pjesëmarrës të projektit. Tri klasat fituese me short gjatë ceremonisë qendrore të mbajtur në Prishtinë kanë kaluar tri ditë vikendi në Brezovicë. Aktivitetet e bëra atje kanë qenë të shumta të cilat edhe janë kurorëzuar me një emision i cili shfaqet në RTK.



Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse

e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

- Pas përgatitjeve të pyetësorëve, shumëzimit të tyre dhe shpërndarjes për secilën nga katër komunat përfituese të projektit, ka filluar edhe monitorimi i katërt në shkolla. Disa nga shkollat kanë përfunduar e të tjerat janë në proces. Presim që gjatë muajit prill të fillojmë me analizën dhe raportin në nivel qendror.

- Grantet shkollore u janë dhënë shkollave dhe tani pasi që komitetet shkollore kanë planifikuar aktivitetin të cilin do ta organizojnë ata edhe do të fillojnë ta realizojnë. Kontratat me këshilltarët e të drejtave të fëmijës në shkollat e synuara janë bërë dhe presim që gjatë muajit prill ti realizojnë projektet e parapara.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

- Në kuadër të komponentës 4 të Projektit, Iniciativat Lokale, në të gjitha shtetet pjesëmarrëse në projekt, shkollat i kanë përfunduar aktivitetet kryesore të mini-projekteve të tyre. Megjithatë aktivitetet në kuadër të këtyre iniciativave do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të projektit. Të gjitha shkollat kanë bërë nga një prezantim të iniciativave të tyre të cilat do ti prezantojnë në konferencën përfundimtare e cila do të mbahet në Durrës, Shqipëri më 8-10 prill 2011, ku edhe do të prezantohen rezultatet e projektit dhe do të diskutohet për mënyrat më të mira dhe më të qëndrueshme të avancimit të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve pakicë në arsim.

Hap pas Hapi

- Në Gjakovë me datën 5 mars u mbajt prezantimi i planifikimeve të pjesëmarrësve në trajnimin për klasën e dytë. Të gjithë pjesëmarrësit u certifikuan pasi që kishin përgatitur dhe realizuar planet javore me tema të caktuara nga ata.

- Në Ferizaj me datën 27 mars u organizua prezantimi i planifikimeve mujore të mësimdhënësve të cilët një muaj përpara morën pjesë në trajnimin Hap pas hapi për klasën e IV. Në këtë grup kishte edhe pjesëmarrës nga Gjilani dhe Prizreni. Të gjithë pjesëmarrësit prezent u certifikuan pas prezantimeve.

- Më 30 mars në Prishtinë pjesëmarrësit që morën pjesë në trajnimin Hap pas hapi për klasën e katërt prezantuan planifikimeve mujore si kusht për certifikim. 4 pjesëmarrës nuk u certifikuan për shkak se nuk i kishin përmbushur kërkesat e dala gjatë trajnimit.

Parandalimi i dhunës në shkolla

- Gjatë muajit mars, janë themeluar 10 Komitete Komunale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe pesë Komitete Rajonale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Gjithashtu gjatë kësaj kohe në pesë aktive komunale të drejtorëve dhe përfaqësuesve të Komiteteve rajonale dhe komunale është bërë prezantimi i Projektit.

- Në komunën e Pejës, përfaqësuesit e Komitetit Komunal për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës kanë bërë monitorimin në shkolla. Përfaqësuesit e KEC, UNICEF, Shërbimit Rajonal të Inspektimit të Arsimit në Pejë, dhe të kanë monitoruar 11 shkolla fillore dhe të mesme të Ulëta të Istogut.

■ Në ndërkohë, në KEC janë përgatitur instrumente për Vetëvlerësim të Zbatimit të Projektit, Rregullore të punës, si dhe Modele për SWOT-analizë të gjendjes në shkolla.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit 2009. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO).

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Gjatë këtij muaji është mbajtur Mbledhja e Këshillit drejtues të projektit. Në anën tjetër, kanë vazhduar aktivitetet e parapara me projekt. Planifikohet të mbahet një punëtori gjatë muajit prill.

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Në kuadër të projektit “Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

■ Është kompletuar faza e parë e trajnimit ku është përfshirë i gjithë stafi qendrave mësimore. Gjatë muajit shkurt deri në mesin e marsit janë trajnuar mbi 90 persona për programin parashkollor

dhe detyra të shtëpisë përmes metodologjisë “hap pas hapi”. Po ashtu në fund të muajit mars është mbajtur trajnimi me fasilituesit e shkrim leximit, ky trajnim është mbajtur në KEC, dhe ligjerues ka pasur një trajner të licencuar nga MASHT për programin “Dritare Jete”.



■ Gjatë fillimit deri kah mesi i muajit mars është bërë furnizimi i gjashtë qendrave me inventar e cila do të ndihmojë qendrat të kenë kushte më të mira të mësimit. Përveç bankave, karrigeve dhe orendive tjera gjatë muajit prill këto qendra do të pajisen edhe me pajisje elektro-shtëpiake si dhe pajisje të teknologjisë informative.

■ Prej 1 mars 2011 ka filluar zyrtarisht implementimi i programeve të projektit EU SIMRAES në qendrat mësimore.



Është mbajtur takimi i parë i komisionit të bursave ku janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve. Në takimin e radhës që do të mbahet në fillim të muajit prill pritet të merret vendimi dhe shpërndarja e bursave prej KEC.

Stafi i projektit EU SIMRAES është takuar gjatë këtij muaji me stafin e projekti EU MRSI që implementojnë projekt në Mitrovicë dhe është arritur marrëveshje konkrete në bashkërendimin e aktiviteteve e cila do të rezultojë me një memorandum të mirëkuptimit. Kjo marrëveshje do të përmbajë hapat konkret të dy palëve ku sa i përket projektit EU MRSI ata do të meremetojnë shkollën në të cilën implementohen aktivitetet e projektit EU SIMRAES si dhe do të shtojnë staf mësimor nëse tejkalohej numri i pjesëmarrësve të paraparë nga projekti EU SIMRAES.

Përgatiti: Petrit Tahiri